



UK Health
Security
Agency



Udhëzuesi për vaksinën kundër COVID-19 për gratë shtatzëna ose gjidhënëse.

Vaksina kundër COVID-19 rekomandohet fort për gratë shtatzëna dhe ato gjidhënëse nga Kolegji Mbretëror i Obstetërve dhe Gjinekologëve (Royal College of Obstetricians and Gynaecologists) dhe Kolegji Mbretëror i Mamive (Royal College of Midwives). Vaksinat kundër koronavirusit (COVID-19) të disponueshme në Mbretërinë e Bashkuar janë mënyra më e sigurt dhe më efektive për t'ju mbrojtur ju dhe fëmijën tuaj.

Këshilla për vaksinën kundër COVID-19 në shtatzëni

Këshilla e Komitetit të Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (JCVI) është se gratë shtatzëna janë më të rrezikuara nga sëmundja e rëndë e COVID-19. Vaksina përforcuese e vjeshtës u ofrohet atyre me rrezik të lartë të ndërlikimeve ndaj infeksionit të COVID-19, të cilët mund të mos kenë marrë një vaksinë përforcuese prej disa muajsh. Këtu përfshihen gratë shtatzëna. Ndërsa numri i infeksioneve të COVID-19 rritet gjatë dimrit, kjo vaksinë përforcuese duhet të ndihmojë në uljen e rrezikut për t'u shtruar në spital me COVID-19. Vaksina përforcuese mund të sigurojë gjithashtu një mbrojtje kundër infeksionit të lehtë Omicron, por një mbrojtje e tillë nuk zgjat për shumë kohë.

Vaksina po ju ofrohet për t'ju mbrojtur ju dhe foshnjën tuaj. Në Mbretërinë e Bashkuar, mbi 250.000 gra janë vaksinuar para lindjes, kryesisht me vaksinat Pfizer dhe Moderna.

Këto vaksina kanë një profil të mirë sigurie tek gratë shtatzëna dhe foshnjat e tyre. Vaksinat kundër COVID-19 nuk përmbajnë koronavirus të gjallë dhe nuk mund të infektojnë një grua shtatzënë ose foshnjën e saj të palindur në mitër.

Provat për vaksinat kundër COVID-19 po shqyrtohen vazhdimisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe organet rregullatore në Mbretërinë e Bashkuar, SHBA, Kanada dhe Evropë.

Vaksina kundër COVID-19 është mënyra më e sigurt dhe më efektive për gratë për të mbrojtur veten dhe foshnjat e tyre kundër sëmundjes së rëndë të COVID-19. Gratë e pavaksinuara që mbeten shtatzënë inkurajohen fort të paraqiten për të bërë vaksinën e tyre.

Gratë që janë shtatzëna dhe janë vaksinuar më parë duhet të marrin një dozë përforcuese këtë vjeshtë.

Përse keni nevojë për vaksinën nëse jeni shtatzënë?

Nëse keni sëmundjen e COVID-19 gjatë shtatzënisë së mëvonshme, si ju ashtu edhe foshnja juaj e palindur jeni në rrezik më të lartë të sëmundjes së rëndë që kërkon trajtim spitalor dhe mbështetje të kujdesit intensiv.

Rreziku i përgjithshëm nga sëmundja e COVID-19 për ju dhe foshnjën tuaj të re është i ulët, por është rritur në valë të ndryshme të COVID-19. Mundësia e infeksionit gjithashtu mund të ndryshojë shumë shpejt dhe pritet të rritet gjatë dimrit.

Vaksinat kundër COVID-19 ju japin nivele të larta mbrojtjeje kundër sëmundjes, por niveli i mbrojtjes bie me kalimin e kohës. Edhe nëse tashmë e keni bërë vaksinën ose e keni kaluar sëmundjen kundër COVID-19, vaksina përforcuese e vjeshtës është e rëndësishme për t'ju ndihmuar ju dhe foshnjën tuaj të qëndroni të sigurt gjatë muajve të ardhshëm të dimrit, kur nivelet e sëmundjes pritet të rriten.

Ka informacione bindëse për sigurinë e vaksinave kundër COVID-19 që u jepen grave shtatzëna në Mbretërinë e Bashkuar, ku mbi 250.000 gra janë vaksinuar para lindjes, si dhe në shumë vende të tjera, përfshirë SHBA-në dhe Australinë.

Koha e vaksinës përforcuese të vjeshtës.

Duhet t'ju ofrohet një takim midis shtatorit dhe dhjetorit, dhe ata që janë në rrezik më të lartë do të thirren të parët.

Ju duhet ta bëni vaksinën përforcuese të paktën 3 muaj pas dozës së fundit të vaksinës.


Ju mund të jeni në gjendje ta bëni vaksinën kundër gripit në të njëjtën kohë. Është e rëndësishme që të jeni të mbrojtura gjatë shtatzënisë për ta mbajtur veten tuaj dhe foshnjën tuaj të sigurt. Mos prisni pasi të keni lindur.



Faktorët e rrezikut për gratë shtatzëna

Nëse vuani nga gjendje shëndetësore themelore të tilla si:

- problemet e imunitetit
- astma
- presioni i lartë i gjakut
- sëmundje të zemrës
- diabeti



Ose nëse jeni:

- mbipeshë
- mbi 35 vjeçe
- në tremujorin e tretë të shtatzënisë (mbi 28 javëshe)
- me prejardhje etnike të minoritetit të zi dhe aziatik
- keni mbetur të pavaksinuara ose pjesërisht të vaksinuara



Ju jeni më të rrezikuara nga COVID-19 sesa gratë e së njëjtës moshë që nuk janë shtatzënë. Gratë shtatzëna me gjendje shëndetësore klinike themelore janë në rrezik më të lartë për të vuajtur nga ndërlikimet e rënda të COVID-19.

Nëse jeni shtatzënë

Rreziqet nga sëmundja e COVID-19 për gratë shtatzëna dhe foshnjat e tyre të palindura dhe sa e lehtë është të infektoheni kanë ndryshuar me lloje të ndryshme të COVID-19. Ne nuk mund të parashikojmë se cilat lloje të reja do të shfaqen, prandaj është e rëndësishme të siguroheni që të jeni të mbrojtura mirë nëse jeni shtatzënë.

Ka prova që vaksinimi në shtatzëni mund të ndihmojë në parandalimin e shtrimeve në spital të foshnjave me COVID-19 në 6 muajt e parë të jetës së tyre. Kjo ndodh për shkak se imuniteti i nënës mund t'i kalojë foshnjës në mitër dhe kjo ofron mbrojtje afatshkurtër pas lindjes.

Gratë që janë shtatzëna klasifikohen si në një grup rreziku klinik brenda programit të vaksinës kundër COVID-19. Gratë e pavaksinuara që mbeten shtatzënë inkurajohen fort t'i bëjnë 2 dozat e para të vaksinës. Gratë që janë shtatzëna dhe janë vaksinuar më parë duhet të marrin një dozë përforcuese këtë vjeshtë.

Shtatzënësia

Nuk ka nevojë të shmangni shtatzënësinë pas vaksinës së COVID-19. Studime të ndryshme shkencore kanë zbuluar se vaksinat kundër COVID-19 nuk kanë asnjë efekt në fertilitetin e meshkujve apo femrave, në shanset tuaja për të mbetur shtatzënë apo në rrezikun e dështimit të foshnjës. Rreth 100.000 gra në Angli janë vaksinuar kundër COVID-19 para se të mbeteshin shtatzënë dhe më pas ato i lindën foshnjat e tyre.

Gjdhënia

Përfitimet e gjdhënies janë të njohura.

Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (JCVI) ka rekomanduar që vaksinat mund të bëhen gatë gjdhënies. Kjo është në përputhje me rekomandimet nga SHBA-ja dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë. Gratë e vaksinuara prodhojnë kundërtrupa që ndihmojnë në mbrojtjen e tyre kundër sëmundjes së COVID-19. Këto kundërtrupa gjenden gjithashtu në qumështin e gjirit dhe mund të ndihmojnë në mbrojtjen e foshnjave që ushqehen me gj. Vetë vakcina nuk depërton në qumështin e gjirit.

Cila vaksinë do t'ju ofrohet?

Do t'ju jepet një dozë përforcuese e një vaccine të prodhuar nga Pfizer ose Moderna. Mund t'ju ofrohet një version i përditësuar i kombinimit të këtyre vaksinave përforcuese - vaksinat e kombinuara përfshijnë një gjysmë doze të vaksinës së mëparshme të kombinuar me një gjysmë doze të një vaccine kundër variantit Omicron. Për një numër shumë të vogël njerëzish, mjeku juaj mund të këshillojë një produkt tjetër vaccine.

Si vaksinat e mëparshme, ashtu edhe ato të kombinuara e përforcojnë shumë mirë mbrojtjen, megjithëse vaksinat e kombinuara prodhojnë nivele pak më të larta të kundërtrupave kundër disa llojeve të variantit Omicron.

Megenëse nuk mund të parashikojmë se cilat variante të COVID-19 do të qarkullojnë këtë dimër, Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (JCVI) ka arritur në përfundimin se të dyja llojet e vaksinave mund të përdoren tek të rriturit dhe se askush nuk duhet ta vonojë vaksinimin për të bërë vaksinat e kombinuara. Kështu që do t'ju ofrohet vakcina e duhur në kohën e duhur.

Ju lutemi ta pranoni vaksinimin që ju ofrohet sa më shpejt që është e mundur - është e rëndësishme ta bëni vaksinën përforcuese dhe të zhvilloni gradualisht mbrojtjen tuaj kundër sëmundjeve të rënda përpara fillimit të dimrit.

Vaksina të tjera të ofruara gjatë shtatzënisë

Në shtatzëni rekomandohen edhe vaksinat për t'ju mbrojtur ju dhe foshnjën tuaj nga gripi, si dhe për të mbrojtur foshnjën tuaj kundër pertusis (kollës së mirë) që nga lindja. Këto vakcina të ndryshme mund të jepen në mënyrë të sigurtë së bashku, ose mund të jepen veçmas dhe ato do të ofrojnë përsëri mbrojtje.

Vaksinat tuaja kundër gripit dhe COVID-19 mund të bëhen së bashku, sepse ato jepen në të njëjtën kohë të vitit në çdo fazë të shtatzënisë.

Është e rëndësishme që ta bëni vaksinën kundër kollës së mirë pasi t'i keni kaluar 16 javë të shtatzënisë për t'u siguruar që fëmija juaj të ketë nivele mjaft të larta mbrojtjeje kur të lindë. Kjo vaksinë zakonisht jepet pas ekografisë suaj kur jeni 18 deri në 20 javëshe shtatzënë dhe kështu ju mund ta bëni këtë vaksinë në një takim tjetër, në varësi të kohës kur mbeteni shtatzënë.

A mund të infektoheni akoma me COVID-19 pasi keni bërë vaksinën?

Vaksina përforcuese kundër COVID-19 do të zvogëlojë mundësinë që të ndiheni mjaft keq nga COVID-19 këtë dimër. Mund të duhen disa ditë që trupi juaj të zhvillojë gradualisht një mbrojtje shtesë nga vakcina përforcuese.

Ashtu si të gjitha ilaçet, asnjë vaksinë nuk është plotësisht efektive – disa njerëz mund të infektohen përsëri me COVID-19 pavarësisht se e kanë bërë një vaksinë, por infeksioni duhet të jetë më pak i rëndë.

Përveç vaksinimit, ka gjëra të thjeshta që mund të bëni në jetën tuaj të përditshme që do të ndihmojnë në reduktimin e përhapjes së COVID-19 dhe infeksioneve të tjera të frymëmarrjes dhe do të mbrojnë ata që janë në rrezik më të lartë. Për më shumë informacion, shihni [Këshillat e Shërbimit Shëndetësor Kombëtar \(NHS\)](#).



Efektet anësore

Ashtu si të gjitha ilaçet, vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore të zakonshme. Efektet anësore të vaksinës kundër COVID-19 janë të ngjashme tek gratë shtatzëna dhe ato jo shtatzëna. Nuk janë identifikuar rreziqe specifike për gratë shtatzëna, shtatzënitë e tyre ose foshnjat e tyre. Mund të jetë e dobishme të siguroheni se çfarë të prisni pasi të keni bërë vaksinën, veçanërisht nëse e keni lindur foshnjën tuaj ose keni fëmijë të tjerë për t'u kujdesur.

Ju lutemi të lexoni [Vaksinimi kundër COVID-19: çfarë të prisni pas vaksinimit](#)

Efektet anësore të zakonshme

Ashtu si me dozën tuaj të mëparshme, efektet anësore të zakonshme janë të njëjta për të gjitha vaksinat kundër COVID-19, duke përfshirë vaksinat e kombinuara që do të përdoren këtë vjeshtë, dhe ato përfshijnë:

- një ndjenjë të dhimbshme, të rëndë dhe butësi në krahun ku keni bërë injeksionin - kjo ka tendencë të jetë më e përkeqësuar rreth 1 deri në 2 ditë pas vaksinës
- ndjenjë lodhjeje
- dhimbje koke
- dhimbje të përgjithshme ose simptoma të lehta të ngjashme me gripin

Ju mund të pushoni dhe të merrni paracetamol (ndiqni këshillën e dozës në paketim) për t'ju ndihmuar të ndiheni më mirë.

Megjithëse ethet mund të shfaqen brenda një ose dy ditësh pas vaksinimit, nëse keni ndonjë simptomë tjetër të COVID-19, ose ethet tuaja zgjasin më shumë, qëndroni në shtëpi dhe mund t'ju duhet të bëni një test. Simptomat pas vaksinimit zakonisht zgjasin më pak se një javë.

Nëse simptomat tuaja duket se përkeqësohen ose nëse jeni të shqetësuar, mund të telefononi Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (NHS) në numrin 111, ose për telefon me tekst përdorni 18001 111. Ju gjithashtu mund t'i raportoni efektet anësore të dyshuara të vaksinave dhe ilaçeve përmes skemës së Kartënit të Verdhë (Yellow Card scheme).

Raportimi i efekteve anësore

Efektet anësore të dyshuara mund të raportohen në Skemën e Kartës së Verdhë (Yellow Card scheme):

- në internet tek [Skema e Kartës së Verdhë \(Yellow Card Scheme\)](#)
- duke telefonuar Skemën e Kartës së Verdhë (Yellow Card scheme) në numrin 0800 731 6789 (nga ora 9.00 e mëngjesit deri në 5.00 pasdite)
- duke shkarkuar dhe përdorur aplikacionin e Kartës së Verdhë (Yellow Card app) për Apple ose Android.



Efekte anësore të rënda

Rastet e inflamacionit të zemrës (të quajtura miokardit ose perikardit) janë raportuar shumë rrallë pasi janë bërë të dyja vaksinat Pfizer dhe Moderna kundër COVID-19. Këto raste janë parë kryesisht tek meshkujt e rinj brenda disa ditësh pas vaksinimit. Shumica e njerëzve të prekur janë ndjerë më mirë dhe e kanë marrë veten shpejt pas pushimit dhe trajtimeve të thjeshta.

Ju duhet të kërkoni urgjentisht këshilla mjekësore nëse pas vaksinimit, keni përjetuar:

- dhimbje kraharori
- gulçim
- ndjenjë e rrahjeve të shpejta të zemrës, fërgëllimeve ose rrahjeve të zemrës në mënyrë të përsëritur.

Nëse keni pasur efekte anësore të rënda pas ndonjë doze të mëparshme, mund t'ju këshillohet të shmangni ose të vononi vaksinimin e mëtejshëm. Ju duhet ta diskutoni këtë me mjekun ose specialistin tuaj. Ju lutemi shihni më poshtë informacionin se si t'i raportoni efektet anësore.

Informacione të mëtejshme

Kolegji Mbretëror i Obstetërve dhe Gjinekologëve (RCOG) dhe Kolegji Mbretëror i Mamive (RCM) kanë informacione të tjera për vaksinat kundër COVID-19 [dhe shtatzëninë, të cilat mund të jenë të dobishme.](#)

Informacione mbi shtatzëninë, gjdhënie, fertilitetin dhe vaksinën kundër COVID-19 në [Shërbimin Shëndetësor Kombëtar \(NHS\), Mbretëri e Bashkuar.](#)

Nëse dëshironi të diskutoni rreth vaksinimit kundër COVID-19, ju lutemi kontaktoni maminë, mjekun ose infermieren tuaj.

